

Biografi – Moisi Duda

Z. Moisi Duda është anëtarë i Këshillit të Lartë të Prokurorisë i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve. Ai është diplomuar si Jurist, pranë Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë.

Karriera e tij si prokuror ka nisur në muajin Gusht të vitit 1990, si hetues pranë Hetuesisë së rrethit Lushnje, më pas si prokuror në Prokurorinë pranë Shkallës së Parë Kuçovë, (1994-1998); Prokuror në Prokurorinë pranë Shkallës së Parë Berat, (1998); Prokuror në Prokurorinë pranë Shkallës së Parë Gramsh, (1989-1999); Prokuror në Prokurorinë pranë Shkallës së Parë Durrës, (2000) si dhe Prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Durrës (2000-2021).

Zoti Duda ka dhënë gjithashtu edhe leksione mbi lëndë si; Drejta Publike, E Drejta Kushtetuese, Histori e Institucioneve, Njohuri Ekonomike, Gjuhë e Huaj (Anglisht), E Drejta Civile, E Drejta Penale, Kodi i Familjes, Kriminalogji, E Drejta Tregtare etj si dhe ka marrë trajnime të ndryshme mbi temë “Luftën kundër krimit të organizuar”, zhvilluar në Itali dhe kurse të ndryshme të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës në Tiranë.

Prej muajt Shkurt të vitit 2021, ushtron detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.